

Djaloshi kish një palë letra dhe dëshiron-te që të lonim me to. Pra, lojmë një konçinë, me gjithë që ay nuk i njinte letrat.

Shumë von rashë të fle, pasi shkova bukur edhe me ata burra të tjeshtë.

Këndeizat e Manastirit na ngritnë që në mëngjes edhe "shënji" na solli ujë për të larë sytë. Për mëngjes na solli vetëm një kafe, ndonëse indirekt i dërgova fjalë se Amerikanët dëshëronin të kenë nonjë vezë të fërguar edhe ca mish ihiu të pregatitur gjithpo në këtë mënyrë. Dëshim të blemë edhe pakëz mish sepse nuk munt të gjenim në për shtëpitë të vobëka, mirpo edhe këtu bëri vesh të shurdhër. Kjo Qelë munt të them se ish një nga Institutet të pasur të Mirditës: bina të mirë, bagëti sado, kollomboq oda plot, zajre gjithpo ashu. Vetëm kish nevojë për njerës me shpirt të Krishterit të vërtetë. Për fat të keq frai nuk u ndoht atje, pa munt të kishim një prijte më të mirë se atë që na bëri shëbëtori farise.

Këtu plotësuam numurin e burrave të Mirditës, edhe na erdhi koha që të nisemi për Pukë. Tani po dëgjonim të tjera fjalë: Puka është vëndi më i keq i Shqipërisë; atje njeriu vdes nga të ftohtët. Në Tiranë kisha dëgjuar se kur duan të dënojnë një ushtar, e dërgojnë më këmbë gjer në Pukë! Kush i merte parasysht të gjitha këto